



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 37/7 Prot.

Tiranë, më 12/5/2015

REKOMANDIM

Nr. 16, datë 12/5/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit, "**Banka Ndërkombëtare Tregtare**" (ICB),

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 07, datë 12.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është realizuar hetimi administrativ pranë kontrolluesit "**Banka Ndërkombëtare Tregtare**" (ICB) me objekt: *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

"Banka Ndërkombëtare Tregtare" (ICB) është kontrollues privat, shoqëri aksionare, e licencuar nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Kontrolluesi e mbështet veprimtarinë e tij kryesisht në ligjin Nr. 8269, datë 23.12.1997 "*Për Bankën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 "*Për Bankat në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, si edhe ligjet e aktet e tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë bankare.

Kontrolluesi "**Banka Ndërkombëtare Tregtare**" (ICB), ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh bankare për individë dhe biznese, të tilla si, llogari rrjedhëse, depozita me afat, financime dhe kredi, karta krediti, transfertat bankare etj. Gjatë kësaj marrëdhënie të krijuar kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale të individëve (klientë), subjekte të të dhënave personale. Në kuadër të veprimtarisë së tij, ndërmjet të tjerash kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve, *klientë, punonjës dhe aksionerë.*

Zyra e Komisionerit konstaton se të dhënat personale për kategorinë "klientë" përpunohen në mënyrë elektronike dhe manuale. Kategoritë e të dhënave personale mbledhen në varësi të shërbimeve dhe produkteve që ofron kontrolluesi. Kontrolluesi, për të gjitha shërbimet apo produktet që ofron, ka hartuar formularë tip nëpërmjet të cilëve mbledh të dhëna personale të cilat i ruan fizikisht së bashku me kopje të dokumenteve ku pasqyrohen këto të dhëna personale. Konstatohet se sistemi elektronik i përdorur nga kontrolluesi parashikon një gamë të gjerë kategorish të dhënash, por nga ana e tij mbledhen vetëm disa kategori të cilat konsiderohen të domosdoshme për përmbushjen e qëllimit, të tilla si: *emri, mbiemri, atësia, datëlindja, kombësia, seksi, nr. i kartës ID, gjendja civile, profesioni, nr. telefoni, e-mail, adresa e banimit.*

Krahas regjistrimit të klientit në sistemin elektronik, kontrolluesi krijon dhe një dosje/kartelë fizike për klientin, në të cilën dokumenton, *aplikimin për regjistrim klienti, kontratën e llogarisë rrjedhëse dhe kushtet e përgjithshme të biznesit.* Për produktet që ofron

kontrolluesi, subjekti i të dhënave/klienti pajiset me kopje të formës së aplikimit, kontratën e shërbimit dhe kushtet e përgjithshme.

Kontrolluesi “Banka Ndërkombëtare Tregtare” (ICB) mbledh dhe përpunon të dhëna edhe për kategorinë e subjekteve të të dhënave “punonjës”, me qëllim administrimin e marrëdhënieve të punës. Të dhënat personale mblidhen nëpërmjet dokumenteve që administrohen në dosjet e punonjësve nga Departamenti i Burimeve Njerëzore. Në këtë kuadër mblidhen këto kategori të dhënash: *emri, mbiemri, atësia, datëlindja, gjendja civile, gjendja penale, gjendja shëndetësore, adresa, shtetësia, arsimimi, kualifikimet, paga etj.*

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për aksionerët e tij. Dosjet personale të tyre mbartin dokumentacione me të dhëna personale të cilat janë të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, të tilla si: *dëshmi penaliteti, vërtetim gjyqësor, vërtetim penal, vërtetim nga tatim taksat, raport financiar personal sekret sipas kushteve të Bankës së Shqipërisë ku hidhen gjendja e të ardhurave, cv, raport biografik* (kërkuar nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë). Dosjet e subjekteve të të dhënave “aksioner” mbahen pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore në masa sigurie.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9887, dt. 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit nëpërmjet procesverbalit të kontrollit konstatoi se:

- ✦ Formulari i njoftimit, nuk është plotësuar në mënyrë të saktë, sa i përket:
 - Rubrikës 1.1 dhe 1.2, në të cilat nuk janë përditësuar të dhënat e subjektit kontrollues dhe të dhënat për personin e kontaktit, të dhënat për komunikim, nr.tel, e-mail;
 - Rubrikës 2.1 dhe 3.1, në të cilat nuk është plotësuar “fusha e veprimtarisë” dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave “punonjës”, “furnizues”;
 - Rubrikës 4.1, në të cilën nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave biometrike për kategorinë “punonjës”;
 - Rubrikës 5.1, në të cilën nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave sensitive në fushën e “shëndetit”;
 - Rubrikës 6.1, në të cilën nuk është deklaruar saktë qëllimi i përgjithshëm i përpunimit të të dhënave personale;
 - Rubrikës 8.1, në të cilën nuk janë plotësuar nën-rubrikat mbi “mjetet dhe mënyrat e transferimit të të dhënave” dhe “qëllimi i transferimit”.

Sa i përket detyrimit për njoftim dhe në vazhdimësi përditësimit të tij (neni 21, 22 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar,) Zyra e Komisionerit vlerëson se është një nga detyrimet bazë që ka çdo kontrollues dhe si i tillë ka një pozicion të rëndësishëm në raport me detyrimet e tjera që parashikon ligji.

Kjo, për faktin që duhet të plotësohet përpara se kontrolluesi të fillojë përpunimin e të dhënave personale, praktikisht përpara se një subjekt privat ose publik të fitojë statusin si “Kontrollues” (i cili lidhet detyrimisht me përpunimin e të dhënave personale). Detyrimi për njoftimin (dhe për përditësimin e tij) nuk mund të konsiderohet i përfunduar dhe i pandryshueshëm në kohë. Ai lind dhe ekziston në çdo rast kur ndryshon një nga elementët e formularit të njoftimit.

Në lidhje me konstatimet e evidentuara në procesverbalin e kontrollit, kontrolluesi nuk ka paraqitur pretendime. Për realizimin e ndryshimeve në “Formularin e Njoftimit”, kontrolluesit i është dhënë një afat prej 5(pesë) ditësh nga dita e nënshkrimit dhe dorëzimit të procesverbalit të kontrollit. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 31.03.2015, përfaqësuesi i kontrolluesit ka deklaruar përmbushjen e detyrimit të lënë nëpërmjet procesverbalit.

Në lidhje me këtë detyrim nga analizimi i "Formularit të Njoftimit" dhe konsultimi i "Rregjistrimit elektronik i njoftimeve" (administruar nga KDIMP), konstatohet se janë plotësuar rubrikat në përmbushje të detyrimit ligjor, sipas deklarimeve të palës së seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore është realizuar nga Zyra e Komisionerit në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm procesin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetin në sektorin bankar. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nga problematikat e hasura më shpesh në këtë fushë. Problematikat i janë referuar praktikës së deritanishme në zbatim të ushtrimit të funksionit monitorues dhe mbikëqyrës së Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit, mangësive të konstatuara gjatë kontrolleve administrative të ushtruara në secilin kontrollues bankar dhe duhen patur parasysh nga kontrolluesit në ushtrimin e aktivitetit.

Sa më sipër, sa i përket të drejtave të subjekteve të të dhënave, Zyra e Komisionerit vlerëson se janë shumë të rëndësishme pasi i japin mundësinë klientit që të mbrojë të dhënat e tij personale. Në kuadër të zbatimit të nenit 5/1/b të ligjit, përfshirja e pëlqimit për qëllime marketingu në formatet e kontratave të ndryshme bankare nuk reflekton qëllimin e ligjit, pasi nuk i jep mundësinë klientit për të kundërshtuar dhënien e pëlqimit për qëllime marketingu. Nëpërmjet kontratës kërkohet të ndërtohet një marrëdhënie kontraktore dhe nuk duhet që klienti të pranojë automatikisht dhe detyrimisht fushatat e marketingut. Pra, klientit duhet t'i jepet mundësia që të kundërshtojë përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu, pa u kushtëzuar nga nënshkrimi i kontratës.

Përsa i përket zbatimit të nenit 18 të ligjit, Zyra e Komisionerit, vlerëson se informimi i klientit është një detyrim që konsiston në mbarëvajtjen dhe transparencën e marrëdhënies midis klientit dhe kontrolluesit. Nëpërmjet informimit, klienti është në gjendje që të kuptojë se çfarë ndodh me të dhënat e tij personale, ku mbahen dhe në ç'formë, për sa kohë mbahen etj, me qëllim që të jetë i ndërgjegjshëm mbi procedurat e përpunimit, duke i dhënë mundësinë për të parandaluar edhe shkelje të mundshme ndaj të dhënave të tij. Saktësimi i qëllimit të përpunimit është i rëndësishëm për shmangien edhe të abuzimeve të mundshme pasi krijohen hapësira që të dhënat të përpunohen edhe për qëllime të tjera jashtë qëllimit fillestar.

Në kuadër të zbatimit të nenit 20 të ligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson që në marrëdhëniet/marrëveshjet që bankat krijojnë me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objektiv përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të sanksionohen rregulla mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave dhe të merren parasysh aktet nënligjore të Zyrës së Komisionerit në këtë drejtim. Plotësimi i këtij detyrimi është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër:

Në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura dhe konstatimeve të realizuara gjatë hetimeve administrative në kontrolluesit që ushtrojnë veprimtari në sektorin bankar;

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5, pika 1/b, nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të tregohet kujdes që në kontratat e shërbimit për produktet bankare, të informohen subjektet e të dhënave për qëllimin e përpunimit të të dhënave në kuadër të marketingut dhe promovimit të produkteve bankare. Të ofrohet mundësia klientit që pëlqimi në këtë rast të jetë opsional dhe i ndarë nga pëlqimi për nënshkrimin e kontratës. Kjo përfshin edhe dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të tjera jashtë qëllimit fillestar të nënshkrimit të kontratës.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të tregohet kujdes që:
 - Në çdo format që sanksionon marrëdhënien e kontrolluesit me subjektet e të dhënave personale (klientin, punonjësën) të parashikohet një dispozitë për informimin e tyre mbi fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave;
 - Në faqen e internetit të kontrolluesit, të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikën e privatësisë", dhe të përditësohen të dhënat, me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
3. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në marrëdhëniet/marrëveshjet që Banka krijon me të tretë (në cilësinë e përpunuesit), që kanë si objekt përpunimin e të dhënave personale (qoftë edhe akses në të dhëna), të sanksionohen rregulla mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave.
4. Në zbatim të nenit 21, 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të tregohet kujdes në vijimësi në përditësimin e Formularit të Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit.
5. Të tregohet kujdes në vijimësi në zbatimin e akteve nënligjore të miratuara nga Zyra e Komisionerit, në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

